

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6244  
E premte, 19 shkurt 2021  
çmimi 0.40 €

## Ambasadori amerikan: Qeveria të formohet shpejt



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT KANË NXITUR REAGIME TË NDRYSHME NË PARTINË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK) DHE NË LIDHJEN DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (LDK)

# SHTOHEN ZËRAT BRENDIA PDK-së DHE LDK-së PËR REFORMA TË THELLA

FAQE 4-5



Humbja e zgjedhjeve të 14 shkurtit ka nxitur reagime të brendshme në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe në Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Zyrtarë të lartë të këtyre partive kanë kërkuar reflektim dhe

reforma rrënjësore në këto dy parti pas rezultateve të dobëta në zgjedhjet e përgjithshme të së dielës. Kryetari i Komunes së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se turrja e kësaj partie është alarmante, duke kërkuar

dorëheqjen e secilit kryetar të degës ku kjo parti ka pësuar humbje të elektoratit. Ndërsa kandidatja për deputete e LDK-së, Besa Gaxherri, ka vlerësuar se në këtë parti duhet reflektim dhe reforma pa improvizime

## OPINION

### LIDER DHE JO MË IDHULL F. 11

Alfons GRISHAJ



### NË FAMILJEN GUCATI, DITËN E PAVARËSISË F. 8



Ismail SYLA


## AKTUALE

### KOZ-ja VENDOS TË RINUMËROHEN 12 VENDVOTIME F. 3

### MBI 6 800 RASTE AKTIVE ME COVID NË KOSOVË F. 9



## EKONOMI



### GUVERNATORI I BQK-SË NJOFTOHET ME KËRKESAT E RRJETIT TË SHITËSVE ME PAKIÇË F. 8

### NITAJ NËNSHKRUAN MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI ME INFRAKOSIN DHE NGROHTOREN E GJAKOVËS F. 8

Reagim i KMDLNj-së

## GJYKATA SPECIALE NUK PO GARANTON GJYKIM TË DREJTË DHE TË PAANSHËM PËR TË AKUZUARIT!

FAQE 5



## QEVERIA NDAN 700 MIJË EURO PËR ZYRTARËT POLICORË DHE MIJËRA EURO PËR KATEGORITË E TJERA

FAQE 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## ShBA-ja duhet ta shtojë angazhimin në Ballkan, thotë ish-presidentja kroate

ZAGREB, 18 SHKURT - Shtetet e Bashkuara duhet ta shtojë angazhimin e tyre në Ballkanin Perëndimor nëse duan t'i bëjnë ballë ndikimit kinez dhe rus në rajon, tha ish-presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović. Ajo ka qenë presidente e Kroacisë nga viti 2015 deri më 2020. Gjatë një diskutimi të organizuar nga Instituti Hoover i Universitetit të Stanfordit, Kitarović kritikoi edhe Bashkimin Evropian për vonesa në procesin e integritetit të këtyre vendeve. "Nëse vërtet dëshironi që t'i parandaloni të

tjerët nga ndërhyrja, atëherë duhet që vetë të përfshihen", tha Grabar-Kitarović, duke iu referuar Shteteve të Bashkuara. Ajo shprehu zhgënjimin për, siç tha, "një lloj mungese të interesimit për rajonin e Ballkanit" nga administratat e presidentit Donald Trump dhe paraardhësit të tij Barack Obama.

Uashingtoni dhe Brukseli kanë bërë përpjekje për integritetin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian (BE) dhe NATO në mënyrë që të sigurojnë

stabilitet në rajonin që u përfshi në luftëra etnike në vitet 1990.

Grabar-Kitarović tha se ky proces ka qenë "shumë i ngadaltë" dhe se "po krijon një hapësirë që po mbushet nga forcat e treta", një referencë e mundshme për Kinën dhe Rusinë. Shtetet e Bashkuara dhe BE-ja kanë shprehur shqetësime në lidhje me investimet nga Pekini në Ballkanin Perëndimor si dhe fushatat e dezinformimit të Kremlinit si dhe veprimtaritë e ndikimit politik në rajon.



## Kosova, notë verbale Malit të Zi për incidentin në autobus

PRISHTINË, 18 SHKURT - Ambasada e Kosovës në Podgoricë i dërgoi notë verbale Ministrisë së Punëve të Jashtme të Malit të Zi, duke kërkuar shpjegim në lidhje me një incident që ndodhi pranë qytetit Berane.

Sipas një deklaratë nga Ministria në detyrë e Punëve të Jashtme e Kosovës, atje u sulmua me gurë një autobus me pasagjerë nga Kosova.

Në bazë të njoftimit, asnjë nga pasagjerët nuk është lënduar dhe autobusi i kompanisë



"Gjafa Tours" ka pësuar vetëm dëme materiale.

Në kohën e incidentit në autobus ndodheshin skiatorë nga Kosova që ktheheshin nga qyteti i Kollashinit në Mal të Zi. Ministria në detyrë e Punëve të Jashtme e Kosovës, Meliza Haradinaj Stublla, tha se ky incident ka shkaktuar frikë për lëvizjen e lirë të qytetarëve midis Kosovës dhe Malit të Zi. "Kosova nuk do ta lejojë minimin e drejtimit euroatlantik të rajonit nga këto incidente të mbjella nga lufta

hibride kundër anëtarëve dhe aleatëve të NATO-s në rajon", tha Haradinaj Stublla.

Ajo u bëri thirrje autoriteteve malazeze që t'i ruajnë "marrëdhëniet e shkëlqyera midis Kosovës dhe Malit të Zi", duke marrë parasysh "rolin dhe rëndësinë e lartë të komunitetit shqiptar në Mal të Zi". Policia në Berane i ka thënë gazetës malazeze "Vijesti" se nuk ka indikacione për një incident të organizuar, porse rasti është regjistruar dhe se bëhet fjalë për një incident sporadik.

## Policia gjermane me operacion të gjerë kundër krimit të organizuar

BERLIN, 18 SHKURT - Policia gjermane ka zhvilluar një aksion bastisjesh në Berlin me qëllim të luftimit të krimit të organizuar. Operacioni vjen si pasojë e një sërë përlëshjesh midis individëve me origjinë arabe dhe çeqene në fund të vitit të kaluar. Policia e Berlinit njoftoi se në bastisje kanë marrë pjesë "disa qindra" pjesëtarë të shërbimeve emergjente dhe forcave speciale. "Pasojë e këtij

operacioni janë hetimet nga ana e prokurorit të përgjithshëm të Berlinit mbi trafikun e armëve dhe drogës si dhe të një mosmarrëveshjeje mes njerëzve me origjinë arabe dhe çeqene që ka ndodhur në muajin nëntor 2020", tha policia.

Revista gjermane "Spiegel" raportoi se gjatë bastisjeve janë arrestuar dy persona. Operacioni kishte në shënjestër një pjesëtar të klanit

kriminal Remmo.

Ky klan i krimit të organizuar përbëhet nga qindra anëtarë, kryesisht me prejardhje të emigrantëve arabë. Remmo u bë pjesë e kryetitujve të mediave kur në nëntor tre pjesëtarë të saj u arrestuan në lidhje me vjedhjen e famshme të bizhuterive me vlerë më shumë se një miliard dollarë në muzeun e famshëm Green Vault të Dresdenit në Gjermani.



## Senatori Bob Dole diagnostikohet me kancer në mushkëri



UASHINGTON, 18 SHKURT - Senatori amerikan Bob Dole ka njoftuar se është diagnostikuar me kancer në mushkëri. Në një postim në "Twitter", Dole tha se do ta nisë trajtimin të hënën. "Derisa kam disa vështirësi përpara, unë gjithashtu e di se iu bashkohem miliona amerikanëve që përballen

me sfida të konsiderueshme shëndetësore", ka pohuar Dole.

Dole ka udhëhequr një delegacion të Shteteve të Bashkuara në Kosovë në vitin 1990. Në muajin gusht të vitit të kaluar busti i tij është vendosur në Prishtinë. Përmes një video-mesazhi, senatori Dole ka shprehur

mirënjohje për inaugurimin e bustit. "Më vjen keq që nuk mund të jem me ju në inaugurimin e bustit. Ma kujton kohën e para 30 vjetëve. Tridhjetë vjet kemi punuar për të krijuar një shtet të fortë dhe shpresoj se do të vazhdoni të punoni për t'u bërë edhe më të fortë", ka thënë Dole.

# Ambasadori amerikan: Qeveria të formohet shpejt

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 SHKURT - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Philip Kosnett, ka bërë thirrje që të formohet qeveria e re shpejt. "Nuk ka kohë për vonesa kur qeveria e re përballet me kaq shumë sfida", ka thënë Kosnett, teksa ka folur në ceremoninë inauguruese të induksionit gjyqësor të Akademisë së Drejtësisë, të enjten në Prishtinë. Ambasadori Kosnett ka theksuar se nuk ka asnjë sfidë më urgjente dhe më të rëndësishme sesa luftimi i pandemisë së Covid-19. Ai ka thënë se qytetarët duhet të mbeten të kujdesshëm dhe vigjilentë, por shtoi se, "për fat të keq, një shkallë e tillë kujdesi nuk është vërejtur nga politikanët dhe qytetarët e

Kosovës në javët përpara zgjedhjeve" të 14 shkurtit. Sipas të dhënave preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 14 shkurt 2021, Lëvizja Vetëvendosje e udhëhequr nga Albin Kurti fitoi rreth 48 për qind, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës me 17.35 për qind. E treta është radhitur Lidhja Demokratike e Kosovës me 13.18 për qind dhe në vendin e katërt është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.42 për qind. Ambasadori Kosnett ka takuar të martën udhëheqësin e Vetëvendosjes, Albin Kurti, me të cilin, siç ka thënë, ka diskutuar për "rrugën përpara të Kosovës". Ambasadori amerikan më herët i ka uruar qytetarët e Kosovës për demonstrim të "përkushtimit ndaj



demokracisë" në ditën e zgjedhjeve. Të enjten Kosnett ka deklaruar se, sikurse zgjedhjet, edhe gjyqësori i pavarur është një shtyllë

kryesore e demokracisë. "Një gjyqësor i pavarur, një gjyqësor që nuk i nënshtrohet presionit politik, është thelbësor për ta mbështetur

sundimin e ligjit. Qytetarët e Kosovës meritojnë një qeveri efektive, që e përmbush mandatin e saj të plotë", ka thënë Kosnett.

## Mbi 6 800 raste aktive me Covid në Kosovë



PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 3 196 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 285 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Deçan një rast (75 vjeç), Gjakovë një rast (78 vjeç), Klinë një rast (90 vjeç), Prishtinë një rast (70 vjeç) dhe Suharekë një rast (84 vjeç). Numri total i rasteve pozitive

është 65 350 raste nga 277 356 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 558 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 319 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 56 974 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 818. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 123 raste, Gjakovë 22 raste, Pejë 22 raste, Podujevë 17 raste, Vushtrri 12 raste, Lipjan 11 raste, Fushë-Kosovë 9 raste, Mitrovicë 9 raste, Rahovec 9 raste, Gjiilan 8 raste, Viti 7 raste, Deçan 5 raste, Prizren 5 raste, Drenas 4 raste, Obiliq 4 raste, Suharekë 4 raste, Dragash 3 raste, Istog 3 raste, Kamenicë 3 raste, Klinë 2 raste dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Malishevë dhe Skenderaj.

## KQZ-ja vendos të rinumërohen 12 vendvotime

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) i ka rekomanduar Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) që të rinumërohen 12 vendvotime. KQZ-ja në mbledhjen e së enjtes e miratoi këtë rekomandim të QNR-së. Burim Ahmetaj nga QNR-ja ka sqaruar arsyet pse duhen rinumëruar këto vendvotime. Ai ka thënë se ka mungesë të nënshkrimeve nga ana e këshillave të vendvotimit dhe formularë të paplotësuar. "Kemi të bëjmë me formularë të përputhjes të dhënave me rezultatet, me formularë të rezultateve të kandidatëve. Në

disa raste kemi mungesë të nënshkrimeve nga ana e këshillave të vendvotimit. Kemi raste kur mungon edhe vetë formulari, mirëpo shumicën e rasteve kemi të bëjmë me mungesën e nënshkrimeve dhe me formularë të paplotësuar. Rekomandimi është që të gjitha këto vendvotime të shkojnë në rinumërim të plotë dhe jo të pjesshëm", ka thënë Ahmetaj. Sipas KQZ-së, vendvotimet që rinumërohen u takojnë disa komunave: Gjakovë (1); Fushë-Kosovë (1); Rahovec (1); Podujevë (3); Prizren (2); Skenderaj (1); Suharekë (1); Ferizaj (1); dhe Vushtrri (1).





ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT KANË NXITUR REAGIME TË NDRYSHME NË PARTINË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK) DHE NË LIDHJEN DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (LDK)

## Shtohen zërat brenda PDK-së dhe LDK-së për reforma të thella

Humbja e zgjedhjeve të 14 shkurtit ka nxitur reagime të brendshme në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe në Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Zyrtarë të lartë të këtyre partive kanë kërkuar reflektim dhe reforma rrënjësore në këto dy parti pas rezultateve të dobëta në zgjedhjet e përgjithshme të së dielës. Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se turrja e kësaj partie është alarmante, duke kërkuar dorëheqjen e secilit kryetar të degës ku kjo parti ka pësuar humbje të elektoratit. Ndërsa kandidatja për deputete e LDK-së, Besa Gaxherri, ka vlerësuar se në këtë parti duhet reflektim dhe reforma pa improvizime

nëndega apo dega, të njohur për montime të votimeve dhe numërimit të votave dhe për rezultate të montuara; Riorganizimin e menjëhershëm në nivel të degëve, duke i bërë të afta për opozitë dhe reflektim politik për nivelin lokal e jo për çështje globale e ndërkombëtare", ka shkruar Lladrovci, duke përmendur edhe masa të tjera. "Lirimin nga detyra të kuadrit të paafte, servil dhe keqberës gjatë dy dekadave e këndej, nëpërmjet një komisioni etik, të krijuar enkas për vlerësimin e personaliteteve të atakuara në media apo nga anëtarët e degëve; Riorganizimin thelbësor të zgjedhjeve të brendshme, larg çdo implikimi nga jashtë, larg çdo paragjykimin të kandidatëve, të imponimeve nga qendra dhe klientelizmit; Publikimi i deklaratës politike të PDK-së dhe vlerave që synon; Debatin e brendshëm për çështjet madhore dhe synimet, nëpërmjet personaliteteve të afta dhe të dëshmuara; Ndryshimin e statutit dhe programit, konform situatës", ka vlerësuar Lladrovci. Edhe kandidatja për deputet e Lidhjes Demokratike të Kosovës

(LDK), Besa Gaxherri, ka thënë se kësaj partie i duhet reflektim dhe reforma pa improvizime. Përmes një shkrimi në profilin e saj në "Facebook", ajo ka falënderuar veprimtarët, simpatizantët dhe votuesit e kësaj partie për mbështetjen që i kanë dhënë në vazhdimësi. "Pas rezultatit të 14 shkurtit, janë ditët më të rënda për të gjithë neve, por pikërisht këto ditë duhet të jenë reflektim dhe assesi improvizim i gjendjes në parti. Dorëheqjet e vonuara duhet të kompensohen me punë, reformë dhe përgjegjësi. LDK-ja ka shumë profile dhe personalitete që ia kthejnë besimin e vlerën LDK-së, por ata persona nuk duhet të pranojnë që përmes improvizimeve ta 'sanojnë' gjendjen, andaj ata që shkaktuan këtë termet në LDK duhet të rrinë larg procesit të reformave. Koha është që njerëzit të cilët e shohin partin si aset kombëtar të mblidhen dhe të ofrojnë platformë e reformë rrënjësore", ka shkruar Gaxherri. Ajo ka shtuar se shtëpia nuk mbahet pa njerëzit të cilët e ndërtuan atë dhe pa ata të cilët e vlerësojnë dhe e mirëmbajnë partinë si shtëpinë e

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 18 SHKURT** - Rezultati jo i mirë i zgjedhjeve të 14 shkurtit ka nxitur pakënaqësi brenda strukturave të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), si dy parti me traditën më të madhe politike në Kosovë.

Zyrtarë të lartë të këtyre subjekteve politike kanë kërkuar nga strukturat partiake të marrin përgjegjësi për rezultatit dhe të reflektojnë ndaj kësaj situatë. Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, përmes një letre publike të publikuar në llogarinë e

vet në "Facebook", ka thënë se turrja e kësaj partie në zgjedhjet e fundit është alarmante. "Secili e di fillimin e vet politik, por jo edhe fundin. Kjo çfarë ngjau në zgjedhjet e 14 shkurtit ishte paralajmërim jo vetëm nga unë, por edhe nga dashamirët, simpatizantët dhe qytetarët që vizionin e Partisë Demokratike të Kosovës e shihnin si slogan për përfitime individuale. Turrja e PDK-së arriti pikën alarmante për shumë arsye. Dështimin na paralajmëroi votimi i vitit 2019. Na paralajmëroi pjesëmarrja jonë në rrëzimin e qeverisë pa u bërë 100 ditë. Na paralajmëroi diaspora. Na paralajmëroi fushata parazgjedhore. Na paralajmëruan

emrat e kandidatëve skematikë të PDK-së dhe qytetari i tmerruar nga mungesa e ndjenjës për ta dhe mirëqenien e tij", ka shkruar Lladrovci. Për të shënuar rikthim të suksesshëm pas katër vjetëve, ai ka thënë se kjo parti në mënyrë urgjente duhet të ndërmarrë disa masa. "Dorëheqja e secilit kryetar të degës ku PDK-ja ka pësuar humbje të elektoratit apo dobësim të ndjeshëm; Lirim nga detyra e secilit drejtues të PDK-së nga kryesia që në opinion ka pasur dhe ka hipoteka për pandershmëri, vepra penale apo akuza; Mënjanimin e manipuluesve të zgjedhjeve të brendshme nga seksioni,

vetme të tyre.

Gaxherri ka theksuar se LDK-ja është aseti politik më i rëndësishëm në Kosovë. "Unë personalisht, nga të paktët kolegë kam përdorur metodën e vërejtjes dhe kritikës brenda organeve të partisë, duke u ballafaquar drejtpërdrejt me problemin dhe përgjegjësinë e lidhshmit, por jashtë shtëpisë gjithmonë e kam mbrojtur këtë shtëpi. Fatkeqësisht, jam keqkuptuar dhe jam penalizuar, duke më konsideruar të papërshtatshme për bashkëpunim, prandaj nuk kam qenë anëtare e kryesisë e as pjesë e qeverive, ndërsa nga jashtë ka mundur të kuptohet se po i mbroj veprimet e këtij lidhshmit. Sugjerimi im është pikërisht ky: çështjet duhet të diskutohen brenda, pa servilizëm, pa improvizime, me maturi e transparencë e kur të kthehen në vendime, nga jashtë të jemi të bashkuar", ka deklaruar Gaxherri. Sipas saj, LDK-ja do të fillojë një rrugëtim të ri, me njerëzit që e duan atë dhe Kosovën. "Me njerëz të devotshëm që janë të gatshëm ta japin më të mirën nga vetja për të mirën e të gjithëve. Kjo është e mundur dhe këtë do ta bëjmë. Ia kemi borxh Kosovës, themeluesve të LDK-së dhe gjeneratave që vijnë", ka thënë ish-deputetja Besa Gaxherri.

Ndërsa njohësi i rrethanave politike në vend, Vigan Qorrolli, ka treguar arsyet për rënien e këtyre subjekteve politike në zgjedhjet e së dielës. Në profilin e vet në "Facebook" ai ka shkruar se eksponentë të lartë të dy partive, PDK-së dhe LDK-së, janë duke pranuar hapur që pjesëmarrja e tyre në rrëzimin e qeverisë Kurti në natën e 25 marsit 2020 ka qenë gabimi më i pafalshëm i tyre. "Më pas krijimi i një qeverie kushtetutshmerisht nule (sipas verdiktit të Gjykatës Kushtetuese) të drejtuar nga LDK-ja, u ka sjellë atyre më shumë sherr se hair në bazat e tyre elektorale. Ky pishman me një vit vonesë nuk është një 'mea culpa'. Është letargji për humbjet e tyre të thella më 14 shkurt 2021", ka shkruar Qorrolli. Sipas tij, këto parti qeverinë Kurti e kanë rëzuar për interesa të veta të ngushta. "Domethënë s'paska qenë Amerika dhe as Grenelli fajtori kujdestar. Ka qenë mizanskena e tyre për pushtet ajo që i ka fundosur gjithandej Kosovës. Rrëzimi i një qeverie legjitime në pikun e pandemisë ishte banaliteti më i madh i këtyre 20 vjetëve jetë politike në Kosovë. Pësimi i thellë electoral i këtyre dy partive është logjika e natyrshme e një nevojë për transformimin e tyre përmbajtësisht të domosdoshëm: kadrovik dhe politik", ka vlerësuar Qorrolli.

Sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, në zgjedhjet e 14 shkurtit Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka marrë 17.41 për qind të votave, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë 13.08 për qind të votave. Fituese absolute e këtyre zgjedhjeve është Lëvizja Vetëvendosje me rreth 48 për qind të votave.

Reagim i KMDLNj-së

# Gjykata Speciale nuk po garanton gjykim të drejtë dhe të paanshëm për të akuzuarit!

Në Gjykatën Speciale në Hagë aktualisht mbahen në paraburgim, si të akuzuar, shtatë (7) shtetas të Kosovës, ish-udhëheqës të lartë të institucioneve të Kosovës dhe ish-themelues dhe ish-udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Jakup Krasniqi, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Sali Mustafa, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. Ndaj të gjithëve është ngritur dhe konfirmuar aktakuza dhe që të gjithëve, me arsyetim stereotip, u është refuzuar kërkesa për mbrojtje në liri. Arsyetimi për refuzim për mbrojtje në liri është i njëjtë për të gjithë të akuzuarit, pavarësisht për natyrën dhe peshën e veprës për të cilën akuzohen.

KMDLNj, që nga fillimi ka reaguar për shkeljen e të drejtave të njeriut të të akuzuarve siç është diskriminimi në përkthimin e materialeve e që e vështirëson përgatitjen e mbrojtjes efektive dhe bashkëpunimit mbrojtës - i akuzuar. Materialet që iu janë dorëzuar të akuzuarve janë përkthyer vetëm pjesërisht ndërsa Gjykata Speciale deklaroi vazhdimisht se materialet po përkthehen. Ende, në disa raste, të akuzuarve nuk iu është dorëzuar arsyetimi i plotë i aktakuzës në gjuhën shqipe dhe për këtë nuk kemi asnjë reagim nga i ashtuquajti

Ombudspersoni i kësaj gjykate që ka mandat të mbrojë të drejtat e të akuzuarve. Me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me Rregullat Evropiane të Burgjeve si dhe me Kushtetutën e Kosovës garantohet një gjykim i drejtë, i pandikuar politikisht dhe i paanshëm duke siguruar të gjitha kushtet për mbrojtje efektive të të akuzuarve e që në rastin konkret keni shkelje të të gjitha këtyre dokumenteve ndërkombëtare si dhe të Kushtetutës së Kosovës, aq më parë që themelues i kësaj Gjykate Speciale është Kuvendi i Kosovës dhe thuhet se kjo gjykatë është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës. Prandaj, duhet ta respektojë Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare e që qartazi nuk e bënë apo e bënë vetëm pjesërisht dhe për nevojat të Prokurorisë apo Gjykatës, në dëm të të akuzuarve dhe mbrojtjes.

Kryeprokurori i Gjykatës Speciale, në disa raste e ka shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë duke deklaruar se të akuzuarit mund të dënohen me burgim të përjetshëm e që paraqet trysni te gjykata që të mos marrë vendim për mbrojtje në liri për asnjë të akuzuar e që paraqet shkelje të rëndë të



drejtave të njeriut, për të akuzuarit. Në fakt, kjo mund të llogaritet si trysni për trupin gjykues duke i konsideruar fajtorë të akuzuarit, ende pa filluar gjykimi. Kjo është e patolerueshme dhe, deri sot nuk pati asnjë reagim, as nga institucionet brenda kësaj gjykate e as nga ato kosovare. Reagimi nuk nënkupton që të akuzuarit të shpallen të pafajshëm pa kaluar një procedurë gjyqësore por se duhet të kërkohet qartazi që të mbrohet parimi i prezumimit të pafajësisë, deri në një vendim të gjykatës kompetente të formës së prerë.

Shkeljeve të drejtave të njeriut të personave të akuzuar po i kontribuon edhe kryetarja e kësaj gjykate, Ekaterina Trandafilova e cila, në çdo paraqitje po i demonizon të akuzuarit duke deklaruar se duan ta shfuqizojnë Gjykatën Speciale edhe si të paraburgosur që janë e që është nonsens dhe ndërhyrje flagrante kundër të akuzuarve. Në fund të fundit, nëse Gjykata Speciale është themeluar nga Kuvendi i Kosovës, sipas të së njëjtës procedurë mund edhe të shfuqizohet.

Kundër të drejtave të njeriut të të akuzuarve nga Prokuroria Speciale në Hagë janë bërë bashkë Kryeprokurori i kësaj Gjykate dhe gjykatësi i procedurës paraprake që duan një gjykim të shpejtë ndonëse këtë po e kundërshtojnë, edhe të akuzuarit si dhe mbrojtësit e tyre. Prokuroria dhe Gjykata Speciale nuk po ua dorëzojnë materialet dhe dëshmitë apo po ua dorëzojnë vetëm pjesërisht mbrojtësve dhe, në këtë mënyrë po e pamundësojnë mbrojtjen efektive. Nëse Prokurorisë Speciale iu janë dashur më

shumë se pesë vite për hetime dhe ngritje të aktakuzës, si mund atëherë mbrojtja të përgatisë një mbrojtje efektive për një kohë aq të shkurtër, sa propozon Prokuroria Speciale dhe Gjykata? Kjo qartazi tregon se nuk ka gatishmëri e as vullnet që të sigurohen kushtet për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht.

Në kuadër të mandatit, KMDLNj monitoron të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria e që janë nën juridiksionin e Kosovës kure, me një Marrëveshje të nënshkruar me Ministrinë e Drejtësisë i shtohen kompetencat që të vizitohen personat e privuar nga liria, shtetas të Kosovës që janë në institucionet përkatëse në Maqedoni të Veriut dhe Shqipëri si dhe në Gjykatën Speciale në Hagë.

KMDLNj bashkëpunon me Prokurorinë Speciale të Kosovës për rastet e dyshuara si krime lufte sikur edhe me viktimat që kanë pësuar gjatë dhe pas luftës, me familjet e tyre si dhe me avokatët mbrojtës.

KMDLNj, në bazë të kërkesës ofron materialet për mbrojtësit e të akuzuarve e që trajtohen nga Gjykata Speciale, familjet e tyre si dhe të ftuarit nga kjo gjykatë, qoftë si të dyshuar apo si dëshmitarë.

KMDLNj-së i janë drejtuar edhe familjarë, avokatë si dhe vet dëshmitarë të mbrojtur dhe, KMDLNj ofron materialet, pa bërë asnjë diskriminim dhe duke e ruajtur konfidencialitetin, që edhe e obligon mandati dhe etika profesionale.

KMDLNj kërkon që të akuzuarit nga Gjykata Speciale e që janë të paraburgosur të trajtohen në përputhje të plotë me të drejtat e

njeriut të personave të privuar nga liria, në përputhje me dokumentet ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe në përputhje me Ligjin për Ekzekutim të Sanksioneve Penale të Kosovës për faktin se është pjesë e sistemit të drejtësisë të Kosovës.

KMDLNj kërkon të respektohet e drejta e përdorimit të gjuhëve zyrtare, në përputhje të plotë me Ligjin për Përdorim të gjuhëve në Kosovë.

KMDLNj kërkon që të përfilllet kërkesa e të akuzuarve si dhe avokatëve mbrojtës që të furnizohen me kohë nga Prokuroria dhe Gjykata me materialet që u ndihmojnë në përgatitjen efektive të mbrojtjes sikur që të kenë kohë të mjaftueshme për organizimin e mbrojtjes. Gjykimi i përsheptuar mund të zbatohet vetëm me pëlqimin dhe marrëveshjen e të akuzuarve me Prokurorinë dhe Gjykatën.

KMDLNj thërret Prokurorinë, Gjykatën dhe veçanërisht kryetaren e Gjykatës të mos e shkelin parimin e prezumimit të pafajësisë, në të kundërtën do të konsiderohet si ndërhyrje flagrante në punën dhe pavarësinë e Gjykatës e që, seriozisht e vë në dyshim të drejtën e të akuzuarve për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. KMDLNj kërkon nga të gjitha palët që të rezervohen nga çdo deklaratë që ua shkel të drejtat e njeriut personave të privuar nga liria e që mund të ndikojnë në vendimin e Gjykatës, e cila, ka përgjegjësi të plotë që, pas provave të proceduara të marrë një vendim, lirues apo fajësues. Kjo është e drejtë dhe përgjegjësi ekskluzive e Gjykatës kompetente!

# NË FAMILJEN GUCATI, DITËN E PAVARËSISË

Takimi në familjen e Hysni Gucati do të më mbetet gjatë në kujtesë. Ditë dimri, e ftohtë. Thua se çdo herë 17 shkurti duhet ta ketë në ADN-në e tij meteorologjike të ftohtin dhe ngricën, për të na kujtuar 17 shkurtin 2008, - ditën më të acartë të vitit kur ndodhi ngjarja më e ngritë e zemrës dhe mendjes shqiptare - pavarësia e Kosovës. Në relievin e pjerrtë kodrinor të Marinës gjendet shtëpia e Avdullah Gucati, tash 85 vjeç. Ai, pas pak kohe, vjen në hapësirën e odës, që është gjysmë bodrum, me tavan të ulët, por e mobiluar tamam si odë mikpritëse, në të cilën na drejtoi nipi i tij, Gëzimi, djali i Hysniut.

Avdullahit, që në kokë mban një plis të bardhë dhe në krahë një pallto me gëzof, që njihet edhe me fjalën "bundë", prejardhjen e së cilës nuk e di, fillimisht ta krijon vështirësinë e të komunikuarit, sepse i është dobësuar shqisa e të dëgjuarit. Por kjo nuk zgjat shumë, sepse dashamirësia e tij e thyen këtë barrierë dhe të folurit me zë të lartë në vend që ta mbys ndejën, kthehet në dëshirë për të dëgjuar për atë çka flet. Kur i them se nuk duket plak me mbi të tetëdhjetat, dhe "kështu si po dukesh paske pleqëri të mbarë, jo me rruhdje të gërditshme" ai pa mëshirë jo vetëm që pajtohet me barrën e moshës, por edhe thekson se e ka gjoksin të prerë, "sallatë" nga operacionet, dhe



vitet mbi moshën 60-vjeçare i duken të tepërta, ku lodhja e organizmit e bën njeriun pa kurrfarë pushteti.

Avdullahu në moshën 63-vjeçare, më 1999, kishte braktisur punën nga Gjermania dhe ishte bashkuar me vullnetarët e UÇK-së në Shqipëri. Komandant i tij kishte qenë Rustem Berisha, i cili kur sheh rekrutin vullnetar goxha të moshuar, i thotë të angazhohet në kuzhinë, "me çiru kumpira", pa ironi. Avdullahu ia kthen me fjalët se nuk ka ardhur këtu për "kumpira" por me luftu e me vdekë, më parë se të vriteshin djem të rinj, 16, 17 e 18-vjeçar, që me vullnet të madh ishin radhitur në njësitet e UÇK-së, ende të njomë dhe pa stërvitje

ushtarake.

Avdullahut i është bërë lëmsh gjendja në Kosovë, sikur ajo flija me qull mielli të grytë të pamjaftueshëm, që në rendat e mbramë përfundon me qull elbi. Pleqëria dhe burgosja e të birit i bëhen të rënda, së bashku me hilenë dinake që i bëhet Kosovës. E ndjen se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës sulmohet pabesisht dhe dinakërisht nga armiqtë e përbetuar të lirisë dhe të pavarësisë së saj.

Ky burrë Drenice, i moshuar në radhët e UÇK-së, edhe më i moshuar në 13 vjetorin e pavarësisë së Kosovës mes dy armiqve të tij, pleqërisë dhe burgut të Hagës, në fund të le përshtypjen mbizotëruese se

pavarësisht kafshimeve të ulëta dhe të pabesa, krenarinë dhe nderin e luftëtarëve nuk do të arrij ta zbeh askush. "Po dojnë me na ba me kanë marre pse kemi luftu për vendin tonë", - thotë veterani 85-vjeçar, Avdullah Gucati, babai i Hysniut, gjyshi i Gëzimit dhe Musliut, që mua dhe Murat Tahirajn na presin me bujarinë tipike shqiptare.

Para se të ndahemi, me veteranin 85-vjeçar, e shkrepi një foto. Në secilën anë të mureve të odës ka korniza me foto të figurave patriotike kombëtare, ka stema të UÇK-së, foto të Adem Jasharit e heronjve tjerë. Unë zgjedh anën ku në prapavijë është korniza me foton e Avdullahut

63-vjeçar me uniformën e UÇK-së.

Dalim nga shtëpia. Jashtë është ftohtë. Kujtohem për ditën. Është e mërkure. Them më vete shumë mirë që nuk është e premtë, që dita e javës të përputhet me përvjetorin e 13 të pavarësisë. Një tersllëk sipas paragjyqimeve të kota. Është 17 shkurt, (kurrë nuk do të ketë 13 shkurt, e premtë e vitit xxx, vit tersllëku, sepse Kosova është shpallur e pavarur njëherë e përgjithmonë me datën 17 shkurt 2008).

P. s.  
Në vend të lamtumirës:  
Familja Gucati, gëzuar Ditën e Pavarësisë!  
(Ismail Sylja)



## Nënshkruhen kontratat për implementimin e sistemit të adresave me gjashtë komuna

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Qeveria Norvegjeze dhe Autoriteti Norvegjez për Hartografi dhe Kadastër "Kartverket" nëpërmjet Agjencisë Kadastrale të Kosovës kanë ofruar një mbështetje financiare për prodhimin dhe instalimin e tabelave të numrave të hyrjeve të objekteve për disa komuna.

Në bazë të konsultimeve mes ekspertëve norvegjezë, ekspertëve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe përfaqësuesve të komunave të ndryshme si dhe në bazë të nevojave dhe prioriteteve të komunave, u vendos që përfituese të kësaj përkrahje të jenë Komuna e Kamenicës,

Komuna e Vitisë, Komuna e Malishevës, Komuna e Obiliqit, Komuna e Ferizajt dhe Komuna e Klinës.

Implementimi i këtij aktiviteti do të bëhet me bashkëfinancim në mes të komunave dhe "Kartverket". Përfitimet nga ky projekt do të jenë shumëdimensionale si për komunat, po ashtu edhe për institucionet e tjera publike, institucionet komerciale dhe bizneset, si dhe për vetë qytetarët e Republikës së Kosovës. Me rastin e nënshkrimit të kontratave, prijësit dhe përfaqësuesit e komunave vlerësoan angazhimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës në përgjithësi dhe bashkëpunimin me komunat në



veçanti, ndërsa kryeshefi i AKK-së, Avni Ahmeti, ka kërkuar nga komunat që t'i caktojnë

ekspertët përgjegjës për këtë projekt, si dhe ka kërkuar trajtimin e mundësive për

ndarjen e mjeteve financiare në baza vjetore për mirëmbajtjen e sistemit të adresave.

# Qeveria ndan 700 mijë euro për zyrtarët policorë dhe mijëra euro për kategoritë e tjera

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 SHKURT - Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka zhvilluar të enjten mbledhjen e 65-të me radhë, në të cilën ka miratuar strategji dhe dokumente të tjera të përgjegjësive të saj kushtetuese dhe ligjore. Strategjia e Sigurisë së Kosovës ka qenë dokumenti i parë që ka marrë miratimin e qeverisë në këtë mbledhje. Ky dokument përcakton drejtimet strategjike të politikave të sigurisë së brendshme dhe të jashtme të vendit tonë përmes të cilave do të sigurohen mbrojtja dhe partneriteti strategjik i sigurisë me miqtë tanë. Dokumenti është në frymën e promovimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe siguron mbrojtjen e interesave të vendit tonë dhe bashkëpunimin me partnerët strategjikë të Kosovës.

Edhe platforma vjetore e politikës së inteligjencës dhe sigurisë për vitin 2021 ka marrë miratimin e qeverisë. Dokumenti bazohet në Ligjin për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës. Ky dokument i dërgohet për informim edhe Komisionit për Mbikëqyrje të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, kabineti qeveritar ka miratuar nismën për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit të Kuvajtit për statusin e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në shtetin e Kuvajtit. Republika e Kosovës deri tash ka 15 marrëveshje të këtilla dhe në këtë frymë është vendosur që të nënshkruhet edhe marrëveshje me shtetin e Kuvajtit.

Qeveria ka miratuar edhe konceptdokumentin për fushën e Policisë Ushtarake, i cili, në bazë të analizës së ofruar, i hap rrugë rregullimit ligjor të Policisë Ushtarake në kuadër të Forcës së Sigurisë së Kosovës që do të jetë një vlerë e shtuar për këtë institucion. Edhe Strategjia e Mbrojtjes e Sigurisë ka marrë miratimin e Qeverisë së Kosovës me të cilën përcakton rregullimin konceptual dhe



organizativ të mbrojtjes në Republikën e Kosovës.

Strategjia riafirmon synimin e Kosovës për anëtarësim në NATO dhe bashkëpunimin me faktorët e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Qeveria ka miratuar edhe Strategjinë Shtetërore të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2020-2025 dhe Planin e veprimit për menaxhimin e integruar të kufirit 2020-2023. Ky dokument është obligim ligjor dhe ka për qëllim ta menaxhojë sigurimin, ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të vendit. Qeveria ka miratuar një vendim për ndarje të mjeteve financiare për pagesën shtesë në pagë për institucione dhe sektorë të ndryshëm që kanë pasur angazhim të shtuar në përbalje me pandeminë Covid-19 si në vijim: 1. Për sektorin e arsimit ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë prej 3 000,000 eurosh për pagesën e shtesës së parë për mësimdhënësit dhe personelin teknik/administrativ në sistemin parauniversitar; 2. Për sektorin e sigurisë, përkatësisht zyrtarët policorë, ndahen mjetet shtesë financiare

në vlerë prej 700 000 eurosh; 3. Për sektorin e emergjencave, përkatësisht zjarrfikësit, ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë totale prej 180 000 eurosh; 4. Për sektorin social ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë 78 000 euro, për pagesën e shtesave në pagë për punëtorët aktivë socialë në Qendrat për Punë Sociale; 5. Për sektorin shëndetësor (në të gjitha nivelet) ndahen mjetet financiare si në vijim: a). Shuma prej 100 000 eurosh për pagesën e shtesave

në pagë për profesionistët shëndetësorë që kryejnë shërbime shëndetësore në sektorin publik bazuar në marrëveshjet kontraktuale që kanë me organizatat buxhetore në nivel lokal; b). Shuma prej 160 000 eurosh për pagesën e shtesave në pagë për punëtorët teknikë të sektorit privat (pastrimi dhe sigurimi fizik) që kryejnë shërbime të kontraktuara për institucionet publike shëndetësore, për dy muaj - shkurt dhe mars 2021;

Kategoritë e tjera të sektorit publik që janë të angazhuar në menaxhimin e pandemisë dhe janë të ekspozuara ndaj rrezikut të infektimit nga Covid-19, që nuk janë pjesë e këtij vendimi apo vendimeve paraprake për shtesa të tilla, do të mund të trajtohen me vendime të veçanta të bazuara në vlerësimet profesionale të nivelit të ekspozimit ndaj rrezikut dhe mundësitë buxhetore, duke filluar nga muaji mars 2021 e tutje.

## Qeveria ndan 40 mijë euro për organizimin e Epopesë së UÇK-së

Qeveria në mbledhjen e së enjtes ka themeluar edhe Komisionin Organizativ për shënimin e "Epopesë së UÇK-së" në përbërje: 1. Anton Çuni, ministër i Mbrojtjes, Kryesues; 2. Bekim Jashari, kryetar i Komunës së Skenderajt, anëtar; 3. Vlora

Dumoshi, ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtare; 4. Meliza Haradinaj-Stublla, ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtare dhe 5. Agim Veliu, Ministër i Punëve të Brendshme, anëtar. 6. Zyra e Presidentit; 7. Kuvendi i

Kosovës; 8. Komuna e Prishtinës; 9. Organizatat e Dala nga Lufta e UÇK-së; 10. Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe 11. Organizatat e shoqërisë civile. Kabineti qeveritar për organizimin e Epopesë së UÇK-së ka ndarë 40 000 euro.

## Nënshkruhet plani bilateral në fushën e mbrojtjes në mes të Kosovës dhe Italisë

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Pas një pune të përbashkët në mes dy delegacioneve, në Shtabin e Përgjithshëm të Mbrojtjes së Republikës së

Italisë, në Romë, për herë të parë u nënshkrua plani bilateral në fushën e mbrojtjes në mes të ministrive të mbrojtjes së Kosovës dhe

Italisë. Planin bilateral përmban aktivitetet kryesore të fushës së mbrojtjes të cilat do të realizohen në mes të Forcave të Armatosura të Republikës së

Italisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Të dyja palët u pajtuan që bashkëpunimi në të ardhmen të zgjerohet e shtohet edhe më tej.



## Guvernatori i BQK-së njoftohet me kërkesat e Rrjetit të Shitësve me Pakicë



PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit e Rrjetit të Shitësve me Pakicë, të kryesuar nga drejtoresha ekzekutive Yllka Metaj. Gjatë takimit guvernatori

Mehmeti ka informuar drejtoreshën Metaj lidhur me masat që BQK-ja ka ndërmarrë gjatë periudhës së pandemisë, me qëllim të lehtësimit të nevojave të bizneseve për likuiditet dhe për t'i ndihmuar ato në aktivitetin e tyre. Gjithashtu, guvernatori

Mehmeti ka njoftuar mysafirët lidhur me planet e BQK-së për përkrahje të mëtejme të lehtësimit të qasjes në financa për bizneset dhe lehtësimeve që do të ndërmerren, në rast të nevojës së mëtejme për t'i ndihmuar bizneset që të përballojnë më lehtë barrën

financiare gjatë procesit të rimëkëmbjes dhe zhvillimit të tyre. Pjesë e diskutimit ishte edhe gjendja aktuale në sektorin financiar, në veçanti atë bankar, i cili vazhdon të jetë i qëndrueshëm, me tregues të lartë të likuiditetit dhe të

kapitalit. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Rrjetit të Shitësve me Pakicë kanë falënderuar guvernatorin Mehmeti për takimin dhe paraqitjen e kërkesat e tyre ndaj BQK-së dhe sektorit bankar, me qëllim të lehtësimit dhe përkrahjes së aktivitetit të bizneseve anëtare të këtij Rrjeti.

## Nitaj nënshkruan marrëveshje mirëkuptimi me Infrakosin dhe Ngrohtoren e Gjakovës



Prishtinë, 18 shkurt (ER) - Ministri në detyrë i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka nënshkruar dy marrëveshje mirëkuptimi për subvencionimin e

dy ndërmarrjeve publike, me Infrakosin dhe me Ngrohtoren e Qytetit në Gjakovë. Drejtorët e këtyre ndërmarrjeve, Xhevat Ramosaj dhe Albana

Skivjani, e kanë njoftuar ministrin Nitaj për afarizmin e ndërmarrjeve të tyre dhe kanë shprehur mirënjohjen e tyre për mbështetjen e dhënë nga Ministria e Ekonomisë

dhe Ambientit. Marrëveshja ka për qëllim mbështetjen financiare nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit për Infrakosin dhe Ngrohtoren e Qytetit Gjakovë

ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, në kategorinë ekonomike "Subvencion dhe transfere".

## Më 25 shkurt mbahet ankandi i tretë i letrave me vlerë për vitin 2021

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Ministria e Financave ka njoftuar se më 25 shkurt 2021 do të mbahet ankandi i tretë për vitin 2021. Në këtë ankand do të emtohen

obligacione me maturitet pesëvjeçar në shumën prej 15 milionë eurosh. Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për

Borxhin Publik, ku interesi i përcaktuar nga tregu u garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (5 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. Për detaje rreth

pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, të interesuarit ta kontaktojnë ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës.





# KRU "Gjakova" u bën thirrje qytetarëve të mos hedhin mbetjet inerte në rrjetin e kanalizimit



Prishtinë, 18 shkurt - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Gjakova" u bën thirrje qytetarëve për më shumë kujdes për rrjetin e kanalizimit.

Zëdhënësjja e KRU "Gjakova", Dafina Syla-Dina, ka kërkuar që mos të hedhin mbetje inerte në rrjetin e kanalizimit pasi në këtë mënyrë po dëmtohet infrastruktura e

kanalizimit. Ajo ka thënë se rastet e bllokimit të pusëve të rrjetit të kanalizimit në Gjakovë, Rahovec janë të shpeshta.

Syla-Dina ka theksuar edhe se abuzimet me kanalizim po ndodhin si pasojë e vetëdijesimit të ulët të qytetarëve sa i përket rrjetit të kanalizimit. "Abuzimet me kanalizim fatkeqësisht janë të

shpeshta si pasojë e vetëdijesimit të ulët të qytetarëve sa i përket rrjetit të kanalizimit. Rrjeti i kanalizimit nuk është funksional nëse vendosim mbetje inerte në sistemin e kanalizimit i cili nuk është i projektuar për t'i absorbuar të gjitha këto mjete inerte. Andaj apelojmë te qytetarët të kenë kujdes në rrjetin e

kanalizimit. Mbetjet e ndryshme nuk duhet të hidhen në kanalizim, duhet të hedhen në kontejner të bërllokut sepse si pasojë e kësaj jemi duke ardhur çdo ditë e më shumë në prishje të infrastrukturës së rrjetit të kanalizimit", ka thënë ajo.

Syla-Dina tregon se intervenimet për deblokim të kanalizimit nuk po bëhen

vetëm në qytetin e Gjakovës, por në gjithë zonën operative ku operojnë. "Jemi në lagjen Brekoc ku KRU 'Gjakova' është duke intervenuar në deblokim të kanalizimit. Këto intervenime janë shumë të shpeshta jo vetëm në qytetin e Gjakovës, por më gjithë zonën operative ku ne operojmë si në Rahovec, Gjakovë si dhe një pjesë e Prizrenit"./kp/

## Grabitet filiali i KEP-it, arrestohet një nga të dyshuarit

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Policia e Kosovës ka arrestuar një person të dyshuar për disa grabitje të ndodhura në rajonin e Prishtinës. I arrestuari dyshohet se është i përfshirë edhe në grabitjen e ndodhur më 8 shkurt në Bulevardin "Bill Klinton" në Prishtinë, i cili bashkë me një tjetër

kishin grabitur filialin e institucionit mikro-financiar të KEP-it, ku kishin marrë një shumë të konsiderueshme parash. "Më 17 shkurt, lidhur me rastin, njësi policor ka arritur të arrestojë një të dyshuar, i cili dyshohet se ka kryer disa grabitje në filialin e institucionit mikro-financiar. Tek i dyshuari është

konfiskuar një revole 'Zoraki', katër fishekë dhe disa rroba që dyshohet se janë përdorë gjatë grabitjeve", thuhet në njoftimin e policisë. Me urdhër të prokurorit, i dyshuari është dërguar në mbajtje, ndërsa policia është në kërkim edhe të personit tjetër të përfshirë në këtë grabitje.



## Komuna e Prishtinës premtion përkrahje për komunitetet

PRISHTINË, 18 SHKURT (ER) - Nënkrjetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit e komunitet rom Ridvan Gashi dhe Adnan Ajeti. Gashi i ka dorëzuar mirënjohje nënkryetarit të Komunës së Prishtinës për kontributin e dhënë për zgjidhjen e çështjeve për këtë komunitet.

Gjatë takimit gjerësisht është diskutuar edhe strategjia e integritit të komunitetit rom në shoqërinë tonë, meqë Ridvan Gashi është koordinator për Kosovë i përzgjedhur nga Unioni Evropian i Romëve JEKHIPE. Komuna e Prishtinës do të vazhdojë t'i përkrahë të gjitha komunitetet edhe në të ardhmen ashtu siç është vepruar edhe deri më tash.



## Gjini e Poweri diskutojnë për projektet për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara



GJAKOVË, 18 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka pritur të enjten në takim shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, Frank Power. Ata biseduan për

bashkëpunimin në mes të Këshillit të Evropës dhe Komunës së Gjakovës, veçanërisht për projektet për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atyre të komuniteteve

joshumicë. Kryetari Gjini u shpreh mirënjohës ndaj Powerit për vizitën dhe mbështetjen e vazhdueshme të Zyrës së Këshillit të Evropës për Komunën e Gjakovës.

## Komuna e Mitrovicës dhe FSK-ja merren vesh për bashkëpunim

MITROVICË, 18 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka mbajtur takim të enjten me nënkolonelin e Forcave të Sigurisë së Kosovës, Afrim Veselin, me të cilin ka biseduar për çështje me interes për qytetarët e komunës dhe mundësitë e thellimit të mëturshëm të bashkëpunimit të ndërsjellë.

Në këtë takim është potencuar se Komuna e Mitrovicës ka qenë dhe është e gatshme ta vazhdojë bashkëpunimin me FSK-në në të mirë të qytetarëve. Në këtë kontekst, kryetari Bahtiri veçoi nevojën për mbështetje në raste emergjente nga FSK-ja që ka kapacitete dhe përvojë të duhur.



## Komuna e Podujevës dhe 'Help' ndihmojnë bizneset e udhëhequra nga gratë

PODUJEVË, 18 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur të enjten në takim Shqipe Breznicën, drejtore të organizatës gjermane "Help" në Kosovë, me të cilën ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet kryetarit Bulliqi dhe drejtore të organizatës "Help", ku ishte edhe drejtori i Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, Pajtim Balaj, ka për qëllim përkrahjen e grave llapjane, që operojnë në fushën e eficientës së energjisë. Bulliqi ka thënë se në bazë të marrëveshjes nga ky projekt do të përfitojnë 20 biznese të udhëhequra nga gratë në Podujevë, me qëllim të rritjes së ndërmarrjes së tyre përmes shfrytëzimit më eficient të

energjisë dhe do të ketë ndikime pozitive në zvogëlimin e kërkesës për energji elektrike dhe shpenzime të ngjashme në sektorin banesor. Në kuadër të projektit bizneset do të mbështeten për të filluar ose zhvilluar bizneset e tyre ku do të përfitojnë donacion për pajisje me vlerë mesatare prej 2,649.00 euro, organizim të biznesit dhe trajnimet profesionale sipas nevojave të klientit si dhe do të bëhet monitorimi i bizneseve të mbështetura.

Zhvillimi i aktiviteteve të përmendura do të financohet me shumën totale të kostos direkte prej 52 980 eurosh (grante dhe trajnime), ndërsa Komuna e Podujevës do të kontribuojë me 25 për qind të shumës totale të investimit që është 13 245 euro.



# Lider dhe jo më idhull



Alfons GRISHAJ

1.

Në kohën tonë lideri modern është misionar dhe jo idhull klasik, sepse koha nuk ia lejon një shkapërcim të tillë, nga lider misionar në idhull dhe nga idhull në legjendë. Aktualisht politikanët perëndimorë nuk mund të bëhen më idhuj. E shikojmë përditë dhe më shumë që idhuj bëhen shpikësit si, p. sh., Steve Jobs, sportistët si Tom Brady, dijetarët dhe filozofët si Wittgenstein, i cili me një libër filozofik, "Tractatus Logico-Philosophicus", u bë një ndër 50 filozofët më të mëdhenj të Perëndimit; shkrimtarë si Joanne Kathleen Rowling, autore e "Harry Potter" etj. Shoqëria moderne civile perëndimore i urren idhujt politikë dhe nuk lejon një impakt të tillë sepse, pasi i jep votën lidërsipit (subjektit) politik, i dorëzon pushtetin brenda një afati kohor të përcaktuar, e jo një pushtet absolut të përhershëm apo të pakontrolluar që do ta bënte liderin diktator dhe pushtetin e tij diktaturë. Kontrata transitorë e mandatit të pushtetit ndiqet e vëzhgohet hap pas hapi nga shoqëria dhe në fund bëhet bilanci dhe vlerësimi historik i arritjeve apo i dështimeve. Që lideri të respektohet apo mbetet i nderuar për një kohë të gjatë në kuptimin historik, kjo varet nga vizioni i drejtimt nga ana e tij, por dhe impresioni i masës, e cila kërkesat dhe pritshmëritë i ka pothuajse gjithmonë të parashtruara në sensin e imediate.

Por, ndodh nganjëherë që lideri në fund të një mandati të lartësohet nga urrejtje e kundërshtarit. Ndërsa 75 milionë amerikanë e përkrahën dhe e votuan Donald Trump si lider, kundërshtarët e sulmuan me dy impeachments të gabuara duke e kthyer atë në legjendë..., fodullëk ky që, do t'u kushtojë demokratëve karriget, sepse ata liderin kundërshtar normal e kthyen në mit!!! Dhe mitet është e vështirë t'i luftosh, sepse më parë duhet t'i zhbësh, gjë që nuk është aspak e lehtë.

Në politikë kanë qenë të paktë liderë që janë bërë idhuj dhe kthyer në legjendë (ne kemi

Gjergj Kastriotin) që kanë bërë histori në shërbim të popujve. Shumë të tillë janë konsumuar nga pushteti që në fazën e parë të ballafaqimit me problemet e shtetit. Ata janë sfumuar dhe avulluar sipas qasjes spekulative, injoro ligjin dhe mbjell lavdi personale mbi të. Bash në ato momente populli ndeshet me vrasjen e shpresës, ku papritmas ndihet i kurthuar në skëterrën e kolapsit të shtetit. Në këto momente dramatike masa njih mēkatin e kthyer në idhull që, për mendimin tim, nuk është asgjë tjetër vetëm puls i vdekjes që fiket ngadalë, ndërsa shpirti largohet e merr arratinë për në skëterrë, duke vështruar nga lart trupin e vet të pajetë të shtrirë mbi dhe masën me duar në kokë.

Ashtu siç shkroi Nietzsche in "Thus Spake Zarathustra" (Kështu foli Zarathustra): "Gjithçka ju jep, po ta adhuroni këtë idhull të ri: kështu ai blen shkëlqimin e virtytit tuaj dhe vështrimin e syve tuaj krenarë. Do ta peshkojë shumicën nëpërmjet jush! Po na u shpik një makinë ferri, një kalë i vdekjes me tingëllim zilesh të ndereve hyjnore".

2.

Sevdaja e idhujve të rremë e ka ndjekur popullin tonë në shekuj. Herë një Ballaban e herë një Enver, herë një Esat e herë një Erdogan, pastaj në djall ti, o vatan! Varfëria dhe pamundësia e ka ndëshkuar keq për këto mëkate, sa dhe sot në shekullin 21 për një grusht miell (e kam thënë dhe më parë), ta jep votën dhe po i ndërtove një kasolle, të jep dhe votën! Renegatë frymorë shfaqen aty-këtu duke ngritur buste pushtuesish e duke bërë tregti me flamurin tonë kombëtar, më i bukuri në alem. Ashtu si Guri Rrokaj që i këndoi Erdoganit. E pra Guri e gurëshët nuk e kuptuan asnjëherë se paketa e ndihmave të Erdoganit s'është tjetër veçse thjesht ambalazhi i ideologjisë ekspansive neootomane dhe i marrëdhënieve tregtare Turqi - Shqipëri. Ai po i ndërton ato shtëpi apo spitale, bash me tetricat e superfitimeve nga këto marrëdhënie, ku prevalojnë prodhimet e dobëta të kompanive me shërbimet më skarco në glob, të sjellja prej tij në Shqipëri, duke ua shitur shqiptarëve "sapunin për djathë" kundrejt një fitimi astronomik, në raport me shërbimin dhe produktin. Dhe kjo dhuratë rip off... vjen bash nga "idhulli" turk, Erdo-Khan! Historikisht, që nga koha Gingham Khan-it, Khanët kanë pasur dëshirë t'i fusin hundët e

tyre që nga zemra e Azisë (Kinë) deri në Evropë e "Arnautllëk".

Sa për ilustrim:

Aktualisht, interneti më i fuqishëm që shitet në Shqipëri nga kompania turke është 100 Mbps (ndërsa në Amerikë, normalisht shkon te 940 Mbps që kushton sipas ofertës, 30-40 dollarë në muaj). Në Amerikë servisi turk do të kushtonte 3-5 \$, ndërsa në Shqipëri shitet 30-40 dollarë. Duke krahasuar nivelin midis dy vendeve konstaton se: Niveli i të ardhurave vjetore për klasën e mesme në USA është 55-110 mijë dollarë në vit, kurse të ardhurat vjetore në Shqipëri për klasën e mesme janë 6 deri në 12 mijë dollarë në vit. Sipas një logjike të thjeshtë matematikore i bie që "Vëllau" turk na e shet internetin e një niveli dhjetë herë më të dobët me një çmim 10 apo 20 herë më të lartë. Nëse këto janë marrëdhënie vëllazërore... që synojnë të na mbajnë sklevër të përjetshëm të një perandorie fantazëm..., mua s'më mbetet gjë tjetër vetëm të them, turqisht: Hosgeldiniz!: "Mirë se erdhët!"

Popullin turk e dua, një herë e një kohë e kam studiuar gjuhën dhe kulturën e tyre, duke shëtitur gjithandej Bizantin e transformuar që quhet Turqi, por që "idhujt" e këtij shteti duan të bëjnë sërish Sulltanat, çka nuk përputhet me idealet e popullit modern turk. Sikur të ish gjallë lideri historik turk me gjak shqiptari, Mustafa Kemal Ataturku, idhull i vërtetë që u bë mit, për shumë arsye, Erdo-Khanët do të ishin gjete!

3.

Pasqyrimi i realitetit të dhimbshëm shihet prej vitesh në jetën politike shqiptare. Ajo ka prodhuar vetëm idhuj të rremë. Dje shumë u gëzuan që votimet në Dardani sollën fitoren e partisë së Albin Kurtit, mbase për një kthesë historike, duke shpresuar të paktën që kursi i zgjedhjeve të reja të mos të ndiqet nga drejtimi me mendësi të vjetra.

Nuk ka rëndësi se kush do të jetë pas atyre që bënë luftën. Nëse Albin Kurti do t'i mbajë të ndenjurat në Evropë dhe mendjen në lindje, ai nuk do të sjellë asgjë të re, vetëm do ta keqësojë situatën. Nëse ai do të këshillohet me njohës të politikës dhe ushtrisë me kahe evropiane dhe perëndimore si dr. Demiraj etj., gjëra të bukura do të bëhen. Personalisht, më pëlqen Albin Kurti, se është shpirt rebel, i lirë, por në politikë... liria ushtrohet sipas një kodi që ka kufij të përcaktuar. Së pari, ai dhe shokët e tij duhet të luftojnë

për identitetin shqiptar, duhet ta korrigojnë flamurin, gjë që nuk e bënë paraardhësit e tij.

Në Dardani, ndihet mungesa e Ghandit shqiptar, Ibrahim Rugova! Partia e tij pësoi një humbje shokuese! Pasuesve të LDK-së dhe popullit dardan do t'u duhen edhe 40 vjet që ta kuptojnë filozofinë e Rugovës, këmbënguljen për mbajtjen e flamurit të Arbërit, pa kompromis. Ai ishte i vetmi politikan intuitiv e vizionar që mund ta bënte Shqipërinë Etnike, ndërsa sot kanë mbetur (përjashtoj Haradinaj e ndonjë tjetër) ca çudibërës që bëjnë zigzage si rrajzat dhe shpeshherë për ta mbuluar inferioritetin e tyre akuzojnë Abrahamin se u ul në tavolinë me Millosheviqin! Jo more bukëshkalë, pengmarrja nuk është ulje në bisedime. Ulje në tryezë ka bërë Fatos Nano, dhe sot askush nuk kujtohet se sa dëm i solli çështjes së Kosovës ai takim me kasapin e Ballkanit. E njëjta gjë dhe sot. Takimet e idhullit të PS, Ramëziu me Aleksandër Vuçiqin prej nga mbijnë teza "të reja" bashkëpunimi që përfshijnë deri edhe shkëmbimin e territoreve.

Sipas mendimit tim, objektiviteti i gjykimit nuk vjen asnjëherë i pastër nga ligësia e klanit subjektiv, por nga pastërtia e qartësia e koshiençës objektive të masës, që jo rrallëherë dhe ajo bëhet irrelative. Koka e udhëheqësit të lindur asnjëherë nuk mund të bëhet hejbe banditësh e as kanaçe lypsarësh, por vetëm skeptër i rrugës së humbur.

Nëse nesër në Shqipëri do të riciklohet e vjetra dhe nuk bëhet rokada e ripërtëritjes së shpresës, krizat do të thellohen, sepse shefi i bandave nuk është lidërsip, por idhull i krijuar nga turma që i shërben vetëm klanit, psikologji kjo e klasës së degraduar që shprehet me motivin: "sa më të fortë të jemi sot, aq më të paprekshëm do të jemi nesër".

Sipas mendimit tim, (pa hyrë në shkencat e filozofisë ky dhe ai tha...), këta janë idhuj artificialë si në kohën prehistorike, të ngjyrosur sot nga dekorat e deklamativ i pompuar nga pasioni partiak. Ata nuk vijnë si krijues, si konstitucionalistë, si njohës shteti, por nga një korrent i intoksikuar nga propaganda e rremë e partisë, dhe prej këtyre humbësve të ngjyrosur, populli shqiptar do të ketë vetëm humbje.

Një popull i vogël me një varrezë të madhe partish është i destinuar të rrijë në vendnumëro ose të ripërsërisë krizat sepse psikologjia e

idhullit kulmon tek uni dhe jo esenca e debatit konstruktiv brenda shoqërisë. Ne shohim që dashuria ndaj vetvetes braktis kufijtë e arsyes duke i anashkaluar kërkesat kolektive. Fatkeqësisht, kjo lloj psikologjie sjell krizat.

Le të ndalemi për një minutë, te themeluesit e panumërt të partisë në Shqipëri, të gjitha janë pjellë e dy partisë nëna. Ata ikin porsa nëna ua ndërpret gjirin, bëjnë kopenë e tyre duke i vendosur një emër grishës dhe e lëshojnë në kullotat ende të paplaçkitura për të vjedhur atë gjelbërim që ka mbetur! Të babëzitur e të pafrenuar në instiktet e tyre kafshërore ata nuk mund të krahasohen dot as më shpirtartësinë e kafshëve të egra që pasi ngopen me prenë e tyre, e ndajnë tepricën me gjahtarët inferiorë sikur të duan të shprehin se e respektojnë kodin minimal të ligjeve të jetës tokësore: jeto por jepu mundësinë dhe të tjerëve që të jetojnë.


Ka ardhur koha për një Übermensch... jo si ai i Nietzhes anti-Krisht, por një mbinjeri që ngjall shpresën dhe shëron plagët e atdheut.

Mjaft më me trazicionin e stërzgjatur dhe idhujt e rremë..., le ta promovojmë një lidërsip të ri modern, një politikan që ka shkëlqyer në portofole të ndryshme, por që nuk ka pasur shans asnjëherë të jetë në krye të punëve të shtetit. Ai po shpalos një program realist dhe vital për ringritjen e Shqipërisë. Sjellja perëndimore e tij dëshmohe në kushtin e parë të kontratës që u ka parashtruar shqiptarëve: "Më provoni, nëse nuk e mbaj fjalën nuk dua mandat të dytë, nuk do kandidoj më"! Kjo tregon se ai e ka matur veten me metrin e kohës dhe di çfarë duhet ndryshuar për të ecur përpara. Vota ime dhe e miqve të mi do të jetë për të edhe sepse demokracia e kërkon domosdoshmërisht rikthimin e opozitës në pushtet, për t'i hapur rrugë zgjidhjes së krizave dhe ngërçeve të shumta politike. Jemi të bindur se Lulëzim Basha, nuk synon ta shndërrojë lidërsipin e tij në objekt idhujtarimi. Por zgjedhjet që të na japin rezultatin që dëshirojmë duhen zhvilluar në atë frymë demokratike perëndimore të diskutimit dhe aprovimit në masë të gjerë të kontratës qeverisëse për vitet e ardhshme.

Vetëm kontrata e popullit me burrat e dheut do të mund t'i shërojë plagët e shoqërisë sonë dhe të çelë një perspektivë të re.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Kosova pëson humbje nga Luksemburgu



**Prishtinë, 18 shkurt** - Kosova ka pësuar nga Luksemburgu 89:99 (23:32, 23:23, 24:20, 19:24), në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023, Grupi B. Ndeshja nisi e baraspeshuar, megjithatë me kalimin e minutave, Luksemburgu u tregua skuadër më e mirë dhe e fitoi çerekun e parë 23:32. Lojë më e barabartë ishte në periudhën e dytë, ku Kosova disa herë tentoi të rikthehet, kurse kjo pjesë përfundon 23:23, ndërsa shkuan në pushim me shifrat 46:55. "Dardanët" rikthehen në periodën e tretë, duke afruar shifrat në 63:64, por mysafirët me një seri prej 9:0, shkëputen sërish në 10 pikë, kurse në

fund me një trepikësh nga Meriton Ismaili, rezultati në semafor pas 30 minutash tregonte shifrat 70:75. Kosova disa herë barazoi rezultatin në 10 minutat e fundit, kurse kur kishin mbetur edhe tre minuta, mysafirët sërish u shkëputen në 84:91. Luksemburgu e ruajti epërsinë deri në fund dhe fitoi 89:99. Sidoqoftë, "Dardanët" kanë ende gjasa për kualifikim. Islanda është në vendin e parë me katër fitore dhe një humbje, ndërsa Sllovakia, Kosova dhe Luksemburgu kanë nga dy fitore dhe tri humbje. Nëse Luksemburgu mposhtet nga Islanda dhe Kosova fiton ndaj Sllovakisë, atëherë do të kualifikohen "Dardanët".

Kosova të shtunën do të përballet me Sllovakinë, kurse Luksemburgu me Islandën. Ndërsa Islanda ka mundur Sllovakinë 79:94 (20:20, 19:23, 16:36, 24:15), në kuadër të parakualifikimeve evropiane në kuadër të Kupës së Botës 2023, Grupi B. Pjesa e parë ishte e baraspeshuar, ku çereku i parë përfundon 20:20, derisa i dyti 19:23. Dallimi i madh u bë në periudhën e tretë, 16:36. Islanda kualifikohet me katër fitore dhe një humbje, kurse Sllovakia ka dy fitore dhe tri humbje. 10 minutat e fundit ishin vetëm formalitet dhe Islanda triumfoi 79:94. Islanda në ndeshjen e fundit të grupit do të ndeshet me Luksemburgun të shtunën, derisa Sllovakia me Kosovën.

### SHKURT

#### Skitari Tahiri zë vendin e 45-të në Itali

Skitari Albin Tahiri zë vendin e 45-të nga 113 garues në Kampionatin Botëror të Cortina d'Ampezzo, disiplina e slallomit të madh. Albin Tahiri është renditur në vendin e 45-të në disiplinën e slallomit të madh në kampionatin botëror, që po mbahet në Cortina d'Ampezzo të Italisë. Tahiri ka përfunduar të dyja lëshimet me kohë 2 minuta, 22 sekonda dhe 21 të qindtat, +11.39 nga vendi i parë. Garën nuk arriti ta përfundojë Arbi Pupovci, i cili gaboi në lëshimin e parë. Nga 113 garues, 78 sosh arritën t'i përfundojnë të dyja lëshimet, ndërsa të tjerët gabuan në lëshimin e parë ose të dytë. Garën nuk e përfundoi as Fiona Blaka-Rusta në konkurrencën e femrave, disiplina e njëjtë. Ajo gaboi në lëshimin e parë. Gara e së enjtes ishte e para për skitarët tanë në botërorin e Cortinas, ndërsa deri në fund të kampionatit do të garojnë edhe në disiplinën e slallomit.

#### Kosova dhe Shqipëria nuk ndryshojnë në ranglistën e FIFA-s

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka nisur vitin e ri në pozitën në të cilën e mbylli vitin e shkuar. FIFA e ka publikuar renditjen e muajit janar, kurse Kosova mbetet në pozitën e 117-të me 1155 pikë të mbledhura. Edhe Shqipëria nuk ka lëvizur në renditje pasi ka mbetur në pozitën e 65-të me 1360 pikë. Ndryshime në ranglistën botërore nuk ka pasur as në dhjetë pozitë e para. Përfaqësuesja e Belgjikës mbetet e para në këtë ranglistë me 1780 pikë të mbledhura duke lënë pas vetes Francën (1755), Brazilin (1743), Anglinë (1670), Portugalinë (1662), Spanjën (1645), Argjentinën (1642), Uruguain (1639), Meksikën (1632) dhe Italinë (1625).

#### Ademi priti rekordmenin Agim Agushi

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, priti të enjten në takim zhonglerin e njohur, njëherësh rekordmenin e Guinness, Agim Agushi, e ku i pranishëm ishte edhe sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu. Agushi shprehu mirënjohje për punën e mirë që po bëhet në FFK në krye me Ademin dhe theksoi se ndihet krenar me Përfaqësuesen e Kosovës, sukseset e së cilës i quajti histori. Krenarinë për rekordet e sportistit të Kosovës shprehu edhe kryetari Ademi, duke thënë se sportistët si ai janë motive për gjeneratat e reja. Ai, po ashtu, e inkurajoi Agushin për ta vazhduar aktivitetin e tij derisa i ofroi edhe përkrahje.

#### Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

Kanë përfunduar katër ndeshje në kuadër të fazës së eliminimit në Ligën e Kampionëve. Liverpooli, PSG-ja, Porto dhe Borussia Dortmundi kanë fituar ndaj kundërshtarëve si Leipzig, Barcelona, Juventus dhe Sevilla. Liga e Kampionëve ka publikuar formacionin më të mirë të javës, ku ndodhen plot gjashtë yje të Liverpoolit. Formacioni i javës: Alisson (Liverpool); Alexander-Arnold (Liverpool), Kabak (Liverpool), Robertson (Liverpool); Dahoud (Dortmund); Chiesa (Juventus), Suso (Sevilla), Salah (Liverpool), Mane (Liverpool); Haaland (Dortmund), Mbappe (PSG).

## Majlinda fiton medaljen e bronzë në Tel Aviv

**PRISHTINË, 18 SHKURT** - Xhudistja nga Kosova, Majlinda Kelmendi e ka fituar medaljen e bronzë në Grand Slamin e xhudos në Tel Aviv. Kampionia Olimpikë në luftë për medalje të bronzë është dashur të takohet me belgen Charline Van Snick, por ajo nuk u

paraqit në tatami për shkak të një lëndimi. Me këtë xhudiste, Majlinda ishte përballur më 11 janar në Mastersin e Dohas, pikërisht për vend të tretë. Majlinda e kishte fituar atë luftë. Ajo në Grand Slamin e Tel Avivit ishte bartësja e parë, por u befusua në gjysmëfinale nga

britanikja Chelsea Giles. Deri në gjysmëfinale Majlinda kishte shënuar dy fitore të vështira. Kosovën në Grand Slamin e Tel Avivit të premtën e përfaqësojnë edhe Akil Gjakova dhe Laura Fazliu. Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe Loriana Kuka pushojnë në këtë garë.



## Feronikeli - Prishtina, ndeshja kryesore në Kupë

PRISHTINË, 18 SHKURT - Në ambientet e stadiumit "Fadil Vokrri" në Prishtinë të enjten, në prani të Komisionit të Garave dhe përfaqësuesve të

klubeve, është bërë tërheqja e shortit për fazën çerekfinale të Kupës së Kosovës. Kryetari i Komisionit, Abdyl Bellopoja, fillimisht i

përshëndeti përfaqësuesit e klubeve në emër të kryetarit Agim Ademi dhe KE të FFK-së dhe u dëshiroi fat në short dhe gara. Ndeshjet e këtij rrethi do

të zhvillohen më 17 mars. Çiftet e Kupës: Feronikeli-Prishtina, Trepça'89-Llapi, Istogu-A&N, Dukagjini-Drenica.



## Bahtiri: Mitrovica mburret me atletin Muhamet Ramadani

MITROVICË, 18 SHKURT - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, dhe nënkryetari Faruk Mujka, të enjten kanë pritur në takim talentin e atletikës, Muhamet Ramadani, i cili ishte i shoqëruar nga trajneri i Klubit të Atletikës "Mitrovica", Shaban Ramadani. Gjatë këtij takimi kryetari Bahtiri ka përgëzuar sportistin mitrovicas për suksesin e arritur në Kampionatin Ballkanik, në Sofje të Bullgarisë, i cili rrëmbeu medaljen e artë në hedhjen e gjyles, duke e përfaqësuar denjësisht Mitrovicën dhe Kosovën në arenën ndërkombëtare. "Me fitoren tuaj në Kampionatin Ballkanik U-20, në hedhje të gjyles, në Sofje të Bullgarisë, ju keni bërë që Mitrovicës t'i shtohet ende nami për suksese në fushën e sportit, prandaj me ju sot mburret i tërë qyteti. Duke qenë krenar për suksesin tuaj të arritur, në emrin tim



personal ju përgëzoj për medaljen e artë të fituar, andaj besoj se falë punës suaj profesionale sukseset do të vazhdojnë edhe në të ardhmen", ka thënë kryetari Bahtiri. Ndërsa trajneri i Klubit të Atletikës "Mitrovica", Shaban Ramadani, falënderoi kryetarin Bahtiri për mbështetjen e vazhdueshme dhe përkrahjen

morale. Pavarësisht prej mundësive të kufizuara buxhetore të cilat i ka komuna, ky klub gjithmonë ka gjetur mbështetjen e kryetarit dhe të komunës. Atleti mitrovicas, Muhamet Ramadani, ka rrëmbyer pesë medalje të arta në arenën ndërkombëtare, katër medalje ballkanike dhe një evropiane në hedhjen e gjyles për grupmoshat U20.

## Utah Jazz nuk ka të ndalur në NBA

LOS ANXHELOS, 18 SHKURT - Utah Jazzi po befason të gjithë me një ecuri fantastike këtë sezon, teksa këtë herë triumfoi në transfertën e vështirë të "Staples Center" ndaj Los Angeles Clippersit dhe regjistroi suksesin e 9 radhazi, duke blinduar pozitat në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit. Sfida në Kaliforni ishte vërtet interesante dhe vendësit e nisën shumë mirë, duke vendosur një epërsi të lehtë pas gjysmës së parë të ndeshjes, por më pas Utah ngriti ndjeshëm nivelin dhe ia doli të triumfojë me shifrat 96-114. Denver Nuggetsit nuk arrin të reagojë pas humbjes me Boston Celticsin, pasi ka pësuar një tjetër disfatë, këtë herë me shifrat e ngushta 130-128 në transfertën ndaj Washington Wizardit në "Capital One Arena".



I udhëhequr nga Murray e Jokiç, Nuggetsit bëri një fraksion të parë mjaft të mirë dhe dha idenë e një fitoreje të lehtë, por më pas pësoi një "black out" total dhe nuk arriti ta rikuperojë më diferencën e pikëve deri në fund. Murray dhe Jokiç ishin pa dyshim nga më të mirët në parket, duke shënauar 68 pikë së bashku, 16 topa të rikuperuar dhe 15 asistime, ndërsa për vendësit shkëlqeu Bertans me 35 pikë, 3 topa të rikuperuar dhe një asistim, raporton "Supersport".

Një sfidë mjaft interesante u zhvillua edhe në "Chase Center" në San Francisco, ku Golden State Warriors triumfoi 120-112 ndaj Miami Heat, por vetëm pas luajtjes së kohës shtesë. Miqtë nga Miami bënë mirë në gjysmën e parë të ndeshjes, por Warriorsi arriti që ta rikthejë baraspeshën deri në fund të kohës së rregullt dhe në 5 minutat shtesë bëri diferencën falë dyshes Curry-Bazemore dhe regjistroi një tjetër sukses duke u ngjitur në zonën "play-off" të renditjes. Me vetëm dy pikë diferencë ia doli të triumfojë edhe Portland

Trail Blazersi në transfertën ndaj New Orleans Pelicansit. Sfida ishte e balancuar gjatë gjithë kohës, por në fund Portlandi bëri diferencën falë edhe një forme të shkëlqyer të Lillardit, që shënoi 43 pikë, rikuperoi 4 topa dhe dha 16 asistime. Në sfidat e tjera Chicago Bulls mposhti Detroit Pistonsin me shifrat 105-102, Boston Celticsi u dorëzua me shifrat 114-122 ndaj Atlanta Hawksit, ndërsa Philadelphia 76ers triumfoi me rezultatin 118-113 ndaj Houston Rocketsit.

### SHKURT

#### Osaka kualifikohet në finale të Australian Openit

Një nga sfidat më interesante në tenis mes dy tenisteve më të mira të botës mes Serena Williamsit dhe Naomi Osakas u zhvillua të enjten dhe në fund u mbyll 0-2 në sete. Ndeshja e madhe në mes të Serena Williamsit dhe Naomi Osakës ka përfunduar me rezultat 0-2 për Osakan. Naomi Osaka arriti që të fitojë 2-0 në sete ndaj Williamsit dhe kështu të kualifikohet për në finalen e madhe të Australian Open. Japonezja vazhdoi përpara dhe kështu do të përballet në finale me Jennifer Brady. Kjo do të jetë finalja e dytë e Australian Openit për Osakan, ndërsa finalja e katërt e Grand Slamit në karrierë.

#### Juventusi bën ofertë zyrtare për Depayn

Sulmuesi Memphis Depay ka refuzuar rinovimin e kontratës me Lyonin që skadon në fund të sezonit dhe ka tërhequr vëmendjen e shumë klubeve të mëdha evropiane. Fakti që ai do të jetë i lirë, ka bërë që skuadrat e mëdha si Juventusi, Barcelona e Borussia Dortmundi të vihen në lëvizje për t'i marrë shërbimet e tij. Sipas mediave italiane, Juventusi ka bërë ofertë zyrtare, teksa bëhet fjalë për një kontratë pesëvjeçare me pagë pesë milionë euro neto në sezon. Favoritja kryesore për ta transferuar sulmuesin holandez është Barcelona, pasi sulmuesi ka raporte të shkëlqyera me trajnerin Ronaldo Koeman.

#### PSG-ja ia cakton çmimin Mbappes

Kylian Mape është një nga lojtarët më të mirë në botë për momentin dhe shumë klube e duan transferimin e tij. Gazeta "Le Parisien", e afërt me klubin francez, raporton se për Mbappen skuadra e PSG-së kërkon 200 milionë euro. Real Madridi, Liverpooli, Juventusi dhe Manchester City janë skuadrat që e dëshirojnë talentin francez, por kjo shumë duket se do ta bllokojë transferimin e 22-vjeçarit në një klub tjetër.

#### Pavard infektohet me Covid

Lazio është kundërshtari që duhet të kalojë Bayern Munchenin për ta siguruar kualifikimin në çerekfinalen e Ligës së Kampionëve. Sfida e parë luhet në Olimpico të Romës të martën e ardhshme (23 shkurt). Trajneri i kampionëve në fuqi, Hansi Flick, ka marrë një lajm negativ. Benjamin Pavard, lojtari që i dhuroi Bayernit triumfin në Botërorin për Klube, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Mbrojtësi francez ka nisur menjëherë karantinën dhe do të mungojë për duelin ndaj "bardhekaltërve" të Inzaghit.

#### Mick Schumacher: Ëndërroj të ngjitem një herë në podium këtë vit

Mick Schumacher përgatitet për debutimin e tij sezonal në Formula 1 me makinën Haas. "Nga njëshi te dhjetëshi, mendoj se jam gati deri në nëntë për sezonin e ri", u shpreh talenti 21-vjeçar gjerman, djali i legjendës Michael Schumacher. "Për fat të keq, kemi vetëm tri ditë teste dhe jo gjashtë apo tetë si zakonisht. Ky është një minus për të gjithë, sidomos për ne debutuesit, ndaj duhet ta përfitoj maksimumin në kaq pak kohë", ka thënë Mick Schumacher. "Formula 1 është speciale për të gjithë, edhe për mua si debutues. Në këtë sport mësohet duke garuar. Përvoja te Haas do të jetë e rëndësishme. Shpresoj që të përfitoj nga rastet që do të më krijohen gjatë sezonit. Synoj të grumbulloj sa më shumë pikë. Nëse do të ketë ndonjë garë të çmendur si vjet, pse jo, ëndërroj të ngjitem një herë në podium këtë vit", ka deklaruar Mick Schumacher.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kiesłowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kiesłowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

ÇMIMI: 5.99 €



ISBN 978-9951-780-37-7

9 789951 780377




AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIESŁOWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

「nga Moisiu deri te Kiesłowski」



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €



ISBN 978-9951-780-10-0

9 789951 780100

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Agro Invent" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 70457698 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Agro Invent" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr. 70457698, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the "Agro Invent" L.L.C. in Pristina, has come to the decision to quit its nr. 70457698, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Dragan Vukasinovic" I.B. Jazhincë, Shtërpcë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për akuakulturë – kultivimin e peshkut në Jazhincë komuna e Shtërpcës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.03.2021 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Hill" në Shtërpcë do të organizohet debat publik nga kompania "Dragan Vukasinovic" I.B. Jazhincë, Shtërpcë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për akuakulturë – kultivimin e peshkut në Jazhincë komuna e Shtërpcës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7640058539?pwd=UGk5N2RkalQ5aGRTRGx6VIRPNCtSUT09>

Meeting ID: 764 005 8539  
Passcode: 2KEHjE

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ▶ Adonis Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën dhe katër dëftesat e shkollës së mesme "Abdyl Frashëri" Prishtinë.
- ▶ D.P.T "Sara" Shpalle te pavlefshme Certifikatën e biznesit me nrb: 70578808
- ▶ Muhamet Ibishi B.I shpalle te pavlefshme Certifikatën e Biznesit me Nrb 80117426
- ▶ Arbësa Smajli shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLM "Dr Xheladin Deda"
- ▶ Mihane Hyseni shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLM "Dr Xheladin Deda"
- ▶ Artan Kalludra shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"
- ▶ Arben Selimi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"
- ▶ Gresa Berisha B.I Shpalle te pavlefshme Certifikatën e biznesit me nrb: 810565228
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

